



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.03.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit-632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË e dt.07.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 05.03.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **05.03.2024;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË me dt.07.03.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Pretendimi juaj se është rekomanduar për kontratë Grupi Operatorëve Ekonomik me çmim më të lartë nuk qëndron, sepse kriter i dhënjes ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm e jo çmimi më i lirë;

2. Pretendimi juaj lidhur me vërtetimet e gjykatës dhe ATK-së, të Grupit të Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk qëndron, sepse të njëjtit kanë dorëzuar në kopje fizike me dt.16.01.2024, kur ju është kërkuar me Letrën standarde të dt 11.01.2024, të cilat janë ende valide përveç Vërtetimit të gjykatës të OE

“MARISA” e cila i është kërkuar edhe njëherë, sepse i ka skaduar afati. Sa i përket vërtetimit të gjykatës për pronarin se nuk është nën hetime, sqarojmë se Autoriteti kontraktues nuk e ka kërkuar;

3. Sa i përket planit dinamik, Autoriteti kontraktues nuk ka caktuar prag dhe meqë Operatori ekonomik ka prezantuar planin dinamik më të shkurtër, në bazë të formulës për tenderin ekonomikisht më të favorshëm është rekomanduar për kontratë, prandaj edhe ky pretendim i juaji nuk qëndron;

4. Pretendimi juaj për qarkullimin financiar, nuk qëndron, sepse edhe vetë keni deklaruar se lideri i grupit ka prezantuar si dëshmi Deklaratën Tatimore Vjetore siç është kërkuar në FDT-ë(e cila e mbulon tërë anëtarë e konzorciumit);

5. Lidhur me numrin e punëtorëve të kërkuar, pretendimi juaj nuk qëndron sepse Grupi i Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar numrin e punëtorëve dhe stafit profesional siç është kërkuar në FDT-ë;

6. Pretendimi juaj se dy kompani pjesëmarrëse në këtë projekt (Marisa dhe Viktory Com), kanë të njëjtin staf profesional dhe se kjo përbën shkelje ligjore, nuk qëndron, sepse vetëm njëri prej tyre është rekomanduar për kontratë;

7. Pretendimi juaj se lidhur me stafin profesional dhe numrin e punëtorëve nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë me nenin 72 të LPP-së, të cilat Grupi Operatoreve Ekonomik i ka sjellë dhe me këtë ka plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë.

8. Pretendimi juaj se dy kompani pjesëmarrëse në këtë projekt (Marisa dhe Viktory Com), kanë të njëjtin makineri dhe se kjo përbën shkelje ligjore, nuk qëndron, sepse vetëm njëri prej tyre është rekomanduar për kontratë;

9. Pretendimi juaj se Grupi Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ne listën e pajisjeve ka paraqitur edhe makineri tjera të marrura me qira por që kontratat e tyre nuk janë në ofertë, nuk qëndron, sepse Grupi Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë(pajisjet e të dy anëtarëve të konzorciumit), ka plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues siç është kërkuar në FDT-ë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

